

SHOQËRIA DIGICOM SH.P.K.

**VENDIM
I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME
TË ORTAKËVE TË SHOQËRISË DIGICOM SH.P.K.**

Nr. 5217, Datë 02.10.2025

Sot, më datë 02.10.2025, ora 11:00 në adresën: Rr. "Papa Gjon Pali II", ABA Business Center, Tiranë, Shqipëri, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë "Digicom" sh.p.k. për të diskutuar dhe vendosur mbi rendin e ditës si vijon:

1. Miratimi i raportit të ekspertit kontabel për rritjen e kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Në mbledhje janë të pranishëm ortakët e shoqërisë:

- **Marin Gjonaj** që përfaqëson 15 % të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë Digicom sh.p.k,
- **Albanian Telecommunications Union** që përfaqëson 85% të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë Digicom sh.p.k, përfaqësuar nga:


1. z. Foto Zbogo
2. z. Agon Feri
3. z. Artan Metaliaj

RENDI I DITËS:

Çështja Nr.1 Miratim i raportit të audituesit ligjor për rritjen e kapitalit themeltar të Shoqërisë

Asambleja e Përgjithshme pas shqyrtimit të Raportit të Audituesit Ligjor, në mënyrë unanime miraton shtimin e kapitalit të Shoqërisë "Digicom" shpk, në vlerën 48,000,000 (Dyzet e tetë million) Lek.

Kapitali i ri i regjistruar për Shoqërinë "Digicom" shpk bëhet në vlerë 287,000,000 (Dyqind e tetëdhjetë e shtatë million) Lek, me ndarje sipas kuotave të mëposhtme:



	Pjesë	Kapitali ishite	Shtesa	Kapitali i ndryshuar
Marin GJONAJ	15	35,850,000	7,200,000	43,050,000
ALBANIAN TELECOMMUNICATIONS UNION	85	203,150,000	40,800,000	243,950,000
	<u>100</u>	<u>235,903,376</u>	<u>48,000,000</u>	<u>287,000,000</u>

Asambleja miratoi në mënyrë unanime depozitim të Vendimit të Asamblesë së bashku me Raportin për zmadhimin e kapitalit të Audituesit Ligjor pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit" te ndryshuar. Ketij Vendimi i bashkëlidhen, Vendimi me të cilin janë miratuar Pasqyrat Financiare per vitin 2024 dhe raporti i Audituesit Ligjor për zmadhimin e kapitalit.


Mbledhja përfundoi pa çështje të tjera për shqyrtim, proces verbal i mbledhjes u hartua dhe u nënshkrua nga të gjithë ortakët me vullnet të lirë dhe të plotë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

SHOQËRIA DIGICOM SH.P.K.

Përfaqësuar nga ortakët:

Marin Gjonaj:




Albanian Telecommunications Union:

Foto Zbogo


Foto Zbogo



Agon Feri



Artan Metaliaj




“DIGICOM” SH.P.K

RAPORT PËR ZMADHIM KAPITALI



FILTO AUDITING

Filto Auditing Sh.p.k
Sheshi Wilson,
Kulla Fati, Kati i VIII,
Tiranë, Shqipëri

E: aresfilto@filtoauditing.com

RAPORT PËR ZMADHIM KAPITALI

Për: "DIGICOM" sh.p.k
Rruga "Papa Gjon Pali II -të", Ndërtesa Nr. 12,
"ABA Business Center", Kati i 19, Zyra Nr. 1901,
Tiranë, Shqipëri

TË NDERUAR ZOTËRINJ

Në bazë të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", shoqëria "DIGICOM" sh.p.k me Vendim të Ortakëve të Shoqërisë të datës 28 qershor 2025 ka vendosur rritjen e kapitalit.

Unë si audites ligjor, konstatova se burimi për rritjen e kapitalit është:

Fitimi i shoqërisë i krijuar në vitin 2024, në vlerë 47,997,886 lekë si dhe rezervat në vlerë 2,114 lekë do të përdoren për rritje kalitali. Unë kontrollova dhe konstatova se fitimi është fitim neto i shoqërisë "DIGICOM" sh.p.k, zbritur të gjitha tatimet e taksat sipas ligjit të cilat shoqëria i ka llogaritur saktë dhe drejt dhe vlerësoj rritje në vlerë 48,000,000 lekë (dyzet e tetë milion).

Bilanci i shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
AKTIVET		
Aktivet afatshkurtra		
Mjete Monetare dhe ekuivalentë të tyre	47,333,876	43,036,333
Llogari të Arkëtueshme	194,583,610	196,665,359
Të tjera të arkëtueshme	37,299,748	20,747,272
Iventare	3,438,588	3,220,105
Totali i Aktiveve Afatshkurtra	282,655,822	263,669,069
Aktivet Afatgjata		
Aktive Afatgjata Financiare	100,000	100,000
Aktive Afatgjata Materiale	614,407,990	607,888,245
Aktive Afatgjata Jo Materiale	44,407,606	55,670,008
Totali i Aktiveve afatgjata	658,915,596	663,658,253
TOTALI I AKTIVEVE	941,571,418	927,327,322
DETYRIMET		
Detyrimet Afatshkurtra		
Huamarrjet	162,453,781	94,553,777
Llogari të pagueshme	75,635,974	235,400,724
Llogari të pagueshme	36,198,966	67,220,044
Të tjera të pagueshme	122,305,231	36,660,744
Totali i detyrimeve afatshkurtra	396,593,952	433,835,289
Detyrimet Afatgjata		
Huamarrjet	254,593,322	410,026,392
Llogari të pagueshme afatgjata	3,234,861	251,105,775
Totali i detyrimeve afatgjata	257,828,183	254,340,636
TOTALI I DETYRIMEVE	254,593,322	688,175,925
KAPITALI		
Kapitali i pronarëve	239,000,000	235,903,376
Rezerva të tjera	151,397	
Fitimi (Humbje) i Pashpërndarë	-	(27,148,007)
Fitimi (Humbje) e vitit	47,997,886	30,396,028
Totali i Kapitalit	287,149,283	239,151,397
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	941,571,418	927,327,322



Gjithashtu konstatova se fitimi i shoqërisë i vitit 2024 janë të pashpërndara por të rikarakterizuara në aktive të shoqërisë.

Nga sa më sipër unë vërtetoj se shoqëria ka burim për shtimin e Kapitalit me vlerën e fitimit dhe të rezervave vitit 2024 në masën 48,000,000 lekë.

Kapitali Themeltar i Shoqërisë bëhet në vlerë 287,000,000 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë milion) lekë i ndarë sipas ortakeve me kuotat ekzistuese si më poshtë:

	Pjesë	Kapitali ishte	Shtesa	Kapitali i ndryshuar
Martin GJONAJ	15	35,850,000	7,200,000	43,050,000
ALBANIAN TELECOMMUNICATIONS UNION	85	203,150,000	40,800,000	243,950,000
	<u>100</u>	<u>239,000,000</u>	<u>48,000,000</u>	<u>287,000,000</u>

Tiranë më, 26 Gusht 2025

FILTO Auditing sh.p.k

Ares FILTO FCCA,

Auditues Ligjor



A handwritten signature in blue ink, located at the bottom right of the page.